



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e nëntëmbëdhjetë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **25.09.2023**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 16. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 17. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 5. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 18. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 19. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 7. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 20. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 8. <u>Liridona Lajçi Avdiaj, LDK;</u> | 21. <u>Andi Xhuraj, PDK;</u> |
| 9. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 10. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Andi Xhuraj PDK;</u> |
| 11. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 24. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 12. <u>Arianit Selmanaj, AAK;</u> | 25. <u>Melis Smakic;</u> |
| 13. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkyetari i Komunës, z. Ali Nimanaj, nënkryetari për Komunitete z. Valmir Rama, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, KFORI-të, monitoruesja nga DEMOS - KDI, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në youtube: : "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit– përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Mbahet një minutë heshtje për policin e vrarë Afrim Bonjaku.

Hap punimet për mbledhjen e nëntëmbëdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezent janë 23 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R E N D D I T E

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Dhënia e betimit nga anëtari i ri i Kuvendit,
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Buxhetit për vitin 2024-2026,
5. Shpallja në diskutim Publik e Draft-Statutit të Qendrës për Punë Sociale në komunën e Istogut,
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit- te pika e dytë, dhënia e betimit nga anëtari i ri i Kuvendit e kam një sqarim, vendimin e kemi marrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që e kemi kërkuar që pas rastit të vdekjes së anëtarit të Kuvendit tashmë të ndjerit Qerim Rexhaj të ndërrimit dhe me sukses është përfunduar ky ndërrim, kështu që ne e kemi futur si pikë të rendit të ditës ndoshta edhe pa e votuar por në mënyrë procedurale duhet ta fus në votim këtë pikë të rendit të ditës ‘dhënia e betimit nga anëtari i ri i Kuvendit’, kush është që kjo pikë e rendit të ditës të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatohet që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime kjo pikë futet në rend të ditës.

Pyes ekzekutivin ose anëtarët e Kuvendit a ka dikush vërejtje ose plotësim të rendit të ditës? Fjalën e ka kryetari i komunës z. Ilir Ferati.

Kryetari i komunës- përshëndet të gjithë të pranishmit! E kemi një kërkesë për një pikë që ta futim në rend dite nëse aprovohet prej anëtarëve të Kuvendit, fjala është për Planin e Punës për ekipin komunal për të drejtat e fëmijëve, është për ta dërguar në diskutim publik. Po e shfrytëzoj rastin pasi e mora fjalën ta përshëndes edhe anëtarin e ri të Kuvendit edhe pse ende nuk e ka dhënë betimin, i uroj punë të mbarë, fat dhe shëndet! Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! E hedhim në votim propozimin e kryetarit, kush është që pika e propozuar nga kryetari i komunës të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatohet që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime kjo pikë futet në rend të ditës.

E hedh në votim edhe gjithë rendin e ditës në tërësi me pikat e shitesë të propozuara, kush është që të procedojmë me këtë rend dite?

Konstatohet që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime miratohet rendi i ditës për ditën e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- në sallë prezent sipas listës së nënshkrimeve janë 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm (përfshirë anëtarin e ri të Kuvendit), Arta Balaj dhe Florin Dreshaj janë lajmëruar ndërsa për dy anëtarë të tjerë nuk kam lajmërim por ndoshta vijnë ndërkohë (kanë qenë të pranishëm).

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- e kemi vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe (lexon vendimin) dhe fton z. Arian Shatri ta jap betimin si anëtar i ri i Kuvendit.

Arian Shatri- jep betimin si anëtar i ri i Kuvendit nga radhët e LVV-së.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka dikush vërejtje ose sugjerime në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Atëherë meqenëse jo, e hedh në votim, kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

Konstatohet që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- z. kryetar fjala është për ju.

Kryetari i komunës- jam i bindur edhe ligjërisht edhe politikisht që është pika më e rëndësishme e rendit të ditës për gjithë vitin. E kemi mbajtur mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ka pasur diskutime të frytshme në raport me Draft-Buxhetin, ju garantoj që është një buxhet gjithëpërfshirës i cili ka dalë pas një mori aktiviteteve prej zyrtarëve kompetent prej drejtorisë së Financave dhe prej të gjithë ne. Është pasqyrim i takimeve me qytetarët të cilat i kemi mbajtur për Kornizën Afatmesme Buxhetore nëpër terren, në bazë të kërkesave që kanë dalë prej tyre, propozimeve, kritikave, sfidave me të cilat ata ballafaqohen në lokalitetet ku ata jetojnë, edhe në bazë të propozimeve që ne i kemi si ekzekutiv për realizimin e vizionit Istogut 2025 po e quaj kështu. Buxheti fatmirësisht ka pësuar ndryshime pozitive ka rritje edhe të investimeve kapitale, ka rritje edhe të subvencioneve, të mallrave dhe shërbimeve, kategori të cilat prekin në mënyrë direkte jetën e qytetarëve ose na e rritin neve mundësinë për me e përmirësuar mirëqenien me anë të ekzekutimit të projekteve të cilat janë të paraqitura në këtë Projekt Buxhet. Sigurisht që një mori e propozimeve kanë ardhur direkt nga qytetarët,

anëtarëve të Kuvendit, drejtorëve, njerëzve të cilët janë kompetent apo përfaqësues direkt të qytetarëve me anë të votës direkte, edhe besoj shumë që një Projekt-Buxhet i tillë do të filloj të realizohet në vitin 2024 do të jap frytet e tij të pasqyrimin përmes ekzekutivit këtyre projekteve që janë jashtëzakonisht në interes të madh të qytetarëve të komunës së Istogut. Është bërë në punë e madhe dhe jo e lehtë edhe në kuptimin procedural edhe në kuptimin politik dhe të paraqitjes së vizionit në mënyrë që investimet të shkojnë nga kompletimi i fotografisë së përgjithshme të ekzekutimit të projekteve, pra jo investime ad-hoc, por investime në plan siç kanë filluar nga viti i kaluar e do të vazhdojnë deri në vitin e fundit të këtij mandati. Ju ftoj që pa dallim politik ta votoni normalisht pas shqyrtimit dhe debatimit të tij dhe në fund të fundit është buxhet që ka me u ekzekutuar në interes të qytetarëve të komunës së Istogut, e vota e të cilëve ju ka sjellë e na ka sjellë të gjithëve këtu me e përfaqësuar edhe me i proceduar interesat e tyre. Nuk po e zgjati më shumë, fjalën ja kisha kaluar zyrtarit kryesor financiar z. Osman Sadikaj që ta bëj elaborimin profesional të këtij Draft-Buxheti. Faleminderit!

Osman Sadikaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton pikën e rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Buxhetit për vitin 2024-2026.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë Osman! Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj-përshëndet të gjithë të pranishmit! I kam disa propozime të cilat nuk janë përfshirë në Buxhetin 2024-2026. Kanalizimi në lagjen "Sadrijaj" fshati Cerkolez, dhe trotuari deri te shkolla, rruga nga shkolla e Uçës- Lagjia "Imeraj" dhe "Sadrijaj", parku dhe këndi i lojrave në Rakosh afër shkollës "Ndre Mjeda", kanalizimi në lagjen "Hasanaj" fshati Uçë, asfaltimi i rrugëve në lagjen "Hasanaj" dhe "Sejdiaj" fshati Uçë, asfaltimi i rrugës në lagjen "Shalaj" në Zallq, kanalizimi në fshatin Zhakovë, lagjia "Mehmetaj" "Salihaj" etj, ndërtimi i urës në fshatin Zhakovë lagjia "Mehmetaj" dhe kanalizimi në fshatin Shalinovicë lagjia "Zeqiraj". E kam edhe një vërejtje te propozimi nga Zhvillimi Ekonomik që është nga burimet tjera. Ceket rruga Osejan-Polanë 535 mijë euro, rruga Llukafci i Thatë-Osejan 400 mijë euro edhe rruga Oprashkë-Shalinovicë 70 mijë euro, d.m.th 1 milionë e 5 mijë euro vetëm për pjesën e Osejanit është nga burimet e tjera të financimit, a jemi të detyruar ne që për Osejan që është diçka e nevojshme për qytetarët e Istogut, apo mos ndoshta ishte dashur që këto 1 milionë me i ndarë për ujë të pijes për Mbi Vadën, apo diçka tjetër të ngjashme, pasi që Osejani dihet që është i lidhur me rrugën në Zallq dhe Kërrninë. Mendoj që personalisht nuk do ta votoj buxhetin për shkak se këto projekte janë futur në Draft- Buxhetin 2024-2026, nuk do të jem unë ai që e ngriti dorën për këto projekte për Osejan, sepse ne në Mbi Vadë nuk kemi ujë të pijes. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka kryetari i komunës.

Kryetari i komunës-të gjitha propozimet Negjdet që kanë ardhur nga qytetarët në Kornizën Afatmesme Buxhetore në një formë titull, a përmbajtje janë të përfshira në këtë Draft-Buxhet. Tendencia me e paraqitur një projekt buxhet nuk po e konsideroj që është e nevojshme të diskutohet, janë propozime që hyn në koordinim me ministrinë e Ambientit departamentin e Infrastrukturës në bazë të planeve që ata i kanë me i realizuar. Janë nivele të diskutimit që kanë të bëjnë me karakter të sigurisë së shtetit e jo me të gjitha bëhet politikë. Projekt-buxheti i ka 13-14 milionë edhe prej burimeve të tjera të financimit që nuk kanë burim të sigurt por janë futur në projekt-buxhet me kërkesë të institucioneve të këtij shteti pjesë e të cilit jemi edhe ne, edhe komuniteti serb që jetojnë në pjesën e Osejanit. Kaq.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! Fjalën e ka Osman Sadikaj.

Osman Sadikaj- shiko shumë nga projektet që i ke propozuar janë të regjistruara, në burimet e tjera të financimit, nëse bën një propozim konkret nga një projekt aktual i propozuar nga ekzekutivi dhe mendoni që ky projekt nuk duhet të jetë por duhet të shtohet një tjetër është procedura e votimit, a aprovohet apo nuk aprovohet. Të gjitha propozimet që vijnë janë të sigurta që do të regjistrohen nga burimet e tjera të financimit. Nëse nuk e kemi në regjister nuk mundemi ta realizojmë si projekt. Dhe këto propozimet e juaja të gjitha do të regjistrohen. Do të kemi bartje do të kemi rishikim të buxhetit dhe do ti realizojmë gjatë vitit ndryshimet eventuale që mendohet që janë me prioritet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Osman! Në formë replike fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- këto propozime nuk i kam shpikur prej mendjes time, por e kam analizuar mirë Draft-Buxhetin, kanalizimi në lagjen "Sadrija" askund nuk figuron, nëse e keni ndërmend me e përfunduar këtë vit ajo është diçka tjetër. Trotuari deri te shkolla, ajo rruga që e ka shtruar qeveria, dihet për çka është shtruar se ka qenë interes nacional i sigurisë, ajo rrugë i rrezikon fëmijët se vozitin shpejt nuk ka trotuar pra është rrugë nacionale. Rruga prej shkollës Uçës, nuk është askund, as parku i lojërave, as kanalizimi në lagjen "Hasanaj" e kërkojnë që disa vite, është asfaltimi i rrugëve në lagjen "Hasanaj" dhe "Sejdiaj" fshati Uçë e kam bërë vet kërkesën ka ardhur prej Zhvillimit Ekonomik që do të shtrohet se kemi dal në terren se është e nevojshme pra nuk figuron askund. Asfaltimi i rrugës në lagjen "Shalaj" në Zallq, nuk figuron. E keni premtuar urën, te lagjia "Mehmetaj" në Zhakovë dhe nuk figuron në Draft-Buxhet. Dhe ne Shalinovicë janë disa shqiptarë aty që jetojnë kanalizim nuk kanë dhe është e tmerrshme në çfarë gjendje jetojnë. Këto janë propozime që i dhashë unë që nuk figurojnë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën rreth kësaj ja kisha dhënë drejtorit Genc Ademaj.

Genc Ademaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Negjdet e kam një pyetje, Qarkoren e parë buxhetore e ke votuar apo? Këto projekte që i ke cekur tani në Osejan ti me dorë tënden i ke votuar të gjitha. Edhe Osjeani është pjesë e komunës së Istogut. Te pjesa e rrugës së Llukafcit të Thatë që e ceka më herët jetojnë jo vetëm komunitet pakicë por edhe komunitet shumicë duhet ta kesh parasysh atë pjesë. Të gjitha memorandumet që nënshkruhen 80% e burimin e tyre e kanë nga lista e projekteve të burimet e tjera të financimit. Të jemi të kujdesshëm në atë çka e prezantojmë se mundesh me e prishur në interes nacional se rruga rajonale R-221 që kalon prej Zallqit në Rakosh mendoj që është në interes nacional, edhe rruga që sivjet ka me filluar në kodër të Rakoshit e në Cerkoz ka me lidhur edhe rrugën te shkolla aty në Uçë pra është e përfshirë në kuadër të atij projekti, për këtë arsye nuk figuron, ti parashtro pyetjen pastaj ne ta japim përgjigjen. Nganjëherë po e shohim shumë ngushtë mundësinë e projekteve, po flasim për 52 fshatra buxheti i vitit të kaluar dhe i këtij viti që është në realizim 2/3 janë të realizuara në pjesën e Mbi Vadës, nëse nuk e prek Uçën se e ka prekur se është ndërtuar ambulante, shtëpia e komunitetit, trotuari, është përruruar shkolla e re etj. Është pjesa e Rakoshit që do bëhet parku që është propozuar edhe nga drejtori i shkollës realizohet këtë vit. Këto propozime çka i ke dhënë te lagjia "Mahmutaj" e kemi dërguar me një projekt me këshillin danez për refugjatë e ka dhënë një fond në dispozicion për me i rregulluar këto ura.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha ti tregoj Gencit që unë e di që te rruga Llukafci i Thatë-Osejan aty jetojnë lagjia "Zeqiraj" pesë gjashtë shtëpi, ata janë të lidhur prej Zallqit, prej Llukafci i Thatë-Osejan përveç Sadush Kabashit dhe një fermer tjetër askush nuk e shfrytëzon atë rrugë, 400 mijë euro e

Mbi Vada nuk ka ujë të pijes po më duket e paarsyeshme me e fut në Draft-Buxhet nga burimet tjera nuk ka lidhje. Unë nuk e votoj këtë buxhet derisa janë këto propozime e këta tjerët ja pafshin hajrin kush do që e voton. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka kryetari i komunës.

Kryetari i komunës- një Sadush dhe gjashtë shtatë të tjerë që komunën e Istogut e kanë bërë komunën numër një prodhuese të qumështit në Republikë të Kosovës. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket shqyrtimit të Draft-Buxhetit të këtij viti d.m.th 2024-2026 nuk ndryshon asgjë në thelb nga vitet e kaluara. Pra më shumë një Draft pa vizion, një buxhet vetëm asfalt deri në sallon. Pra që mendohet vetëm deri te zgjedhjet e ardhshme e jo për gjeneratën e re, e fokus i premtimeve të LDK-së normal ka qenë zhvillimi ekonomik, zhvillimi i turizmit, zhvillimi i bujqësisë që e përmendi edhe kryetari, i rinisë i sportit edhe i ujit 24 orë, pra si premtim elektorale. Siç e pashë, katër drejtori shtrojnë asfalt, trasojnë rrugë, kanalizim, apo ndonjë trotuar aty këtu. Dhe në bazë të asaj siç i numërova unë të katër drejtoritë, 30 fshatra janë të përmendura, edhe pse komuna ka më shumë fshatra. Në këtë mënyrë buxheti nuk është ndarë drejtë. Komuna duhet të zhvillojë politika që ndikojnë në zhvillim në punësim, ndaj propozojmë që të ketë fond për bizneset ekzistuese, për promovimin e prodhimeve nga bizneset istogase, përmes panairove dhe përkrahjeve të tjera, me e themeluar inkubatorin e biznesit që me i përkrahur projektet inovative dhe bizneset fillestare me grante për të rinjtë dhe gratë në biznes. Të gjejmë mjete të nevojshme për investimin dhe zhvillimin e turizmit si specifikë e jona. Meqenëse se kryetari ka pas premtuar projekt milionësh për zonën turistike të "Bukuroshës së Ballkanit" në Moknë, kërkojmë që ai premtim të mbahet, sepse për këto punë normal është drejtoria për Zhvillim Ekonomik e nuk është të shtroj rrugica. Komuna duhet të shërbej edhe bujqësisë e jo vetëm kompanive të betonit, jemi vend rural dhe bujqësor, i kemi ndarë vetëm 60 mijë euro për subvencione. Andaj ne propozojmë siç e përmendi kryetari për qumështin që të subvencionohen me tetë cent për litër të gjithë qumështarët sepse kështu e kemi parë që është e nevojshme me i përkrah. Ka edhe precedent që ka ndodhur edhe në komuna të tjera. Fond për subvencionimin e blegtove që kanë dëme nga kafshët e egra. Propozojmë përpilimin e një strategjie që do të ishte udhërrëfyes për të gjithë bujqit që do të ndikonte në rritjen e sipërfaqeve të mbjella me çaj dhe bimë aromatike meqenëse kemi pika grumbulluese dhe këto i eksportojnë edhe jashtë. Të ndihmohen prodhuesit e mollës që e kemi edhe këtë si specifikë, në mbrojtje të bimëve dhe me pesticide, si dhe një fond për rastet emergjente që po shkaktohen nga të reshurat atmosferike. Problemi tjetër që po përballemi si komunë është edhe ikja e rinisë e që në komunën e Istogut nëse analizojmë nuk kanë asnjë sallë palestre sportive ku mundën me i zhvilluar aktivitetet. Gjithashtu me e ndarë një fond pak më të madh se 60 mijë euro subvencione për të gjitha këto klube sportive që janë në Istog. E nga projektet kapitale e pashë që janë katër një prej të cilave ka ardhur nga drejtoria për Arsim, dhe ka kaluar në drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, është palestra e sportit në Vrellë që janë ndarë 150 mijë euro për me e përmirësuar një gabim, e do Zoti përfundohet shpejt. Për të gjitha këto mjetet janë vetëm duhet me e ndaluar asfaltin e mos me i shtruar edhe rrugicat, ne besojmë që ky Draft nuk i përfshinë të gjithë e nuk ka shpërndarje të barabartë, nuk ka prioritet ashtu siç e ceka më lartë, shumë projekte nuk kanë as burim real të financimit dhe janë në nivel të dëshirores. Andaj unë si anëtar i Kuvendit por edhe grupi i jonë i asamblistëve nuk ka votë për këtë buxhet pa vizion. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit i nderuar! Fjalën e ka kryetari i komunës.

Kryetari i komunës- një fjalim i mirë Niman! I mirë për veshin e atyre që mendojnë si ti, e që nuk ju duhen as shifrat as analizat as propozimet konkrete. Thotë janë prekur vetëm 33 fshatra harron që vitin e kaluar janë prekur 42 fshatra. Jap propozime për tetë cent në litër për qumështarët dhe harron që ne i kemi vetëm 38 mijë banorë, që ndikon direkt në kategorinë e subvencioneve. Faleminderit Niman edhe njëherë për këtë lloj fjalimi. Një gjë për ty dhe për të gjithë, ky ekzekutiv ka vizion dhe ky vizion ka me dalë në test në zgjedhjet e ardhshme lokale, nuk po guxoj të them edhe 24 vjet se gjatë ama edhe aq shumë vjet sa ndoshta kthehet Lëvizja Vetëvendosje në organizatë joqeveritare prej partisë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! Fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Sot për mua dhe për ju kolegë është dita më e veçantë e këtij viti, se kemi me e votuar Draft-Buxhetin 2024-2026, ku shumë qytetarë të Istogut presin nga ne që e kemi marrë votën për mirëqenie dhe me ja u përmirësuar jetën atyre qytetarëve. Kështu që kryetari me ekipin e tij ka zhvilluar të gjitha debatet me qytetarë me neve anëtarët e Kuvendit dhe e ka bërë një Draft që ju përshtatet qytetarëve. Po e harrojmë që kryetari me planin e vet i ka fituar zgjedhjet edhe e ka obligim moral ndaj atyre qytetarëve që at plan program brenda katër vjetëve ta realizoj dhe të dalë para qytetarëve me ato projekte që i ka premtuar, prandaj fatmirësisht të gjitha partitë që jemi këtu, të gjitha kanë kryetar nëpër komuna, le të rrinë nga pak me ata kolegë, dhe të mësohen si bëhet Draft-Buxheti. Draft-Buxhetin e bënë kryetari me ekipin e vet me atë projekt që i kanë besuar qytetarët, prapë ia kryetar del para qytetarëve dhe e kërkon votën, prandaj është një praktikë ku LDK-ja në Istog që 24 vite e praktikon këtë gjë, që 24 vite i ka fituar zgjedhjet me këtë buxhet dhe besoj që LDK-ja buxhetin di ta bëj dhe ju ka përshtatur qytetarëve. Thotë kolegu vetëm asfalt, nuk e di a ke qenë në debate me qytetarët se vet e kërkojnë asfaltin, kanalizimin ujësjellësin, të mira janë edhe të gjitha ato që i ke premtuar ti, por duhet ta dish a kemi buxhet, në buxhet siç është i Istogut, komunë e vogël, nuk mundet t'i përfshijë të gjitha ato, se të kishim buxhet edhe kryetari do kishte qenë shumë i kënaqur me pas mundësi me i subvencionuar edhe qumështarët edhe rininë edhe të gjitha, por ky është buxheti as ne as kryetari nuk jemi të kënaqur me këtë buxhet që kemi aq shumë prioritet tjera që kishim pasur nga ti dërgojmë, por këto janë mundësitë buxhetore që na lejojnë, pra brenda këtyre mundësive buxhetore duhet ta gjejmë një zgjidhje më të mirë dhe më të mundshme për qytetarët. Unë jam që disa vite në këtë Kuvend, ka ndodhur që të gjithë delegatët e kanë aprovuar buxhetin dhe besoj që do ishte dashur prapë të aprovojme buxhetin sepse është buxhet i qytetarëve. Prandaj ju kisha kërkuar si qytetar si koleg ta aprovojme këtë buxhet, edhe unë kam propozime edhe të tjerët kanë, as të miam nuk janë të përfshira të gjitha as te vet kryetarit.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit i nderuar! Fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Projektet që janë vendosur, është vërtetë që nuk kanë mundur të përfshihen të gjitha fshatrat, por në fakt është shtrirë në një lloj mënyre, por unë si kuvendare i kam analizuar këto projekte të gjitha janë të mira, të gjitha janë në interes të qytetarëve, por ka edhe shumë projekte që nuk kanë mundur të hynë në kuadër të këtij projekt-buxheti, më ka bërë përshtypje më së shumti vazhdimi i projekteve që kanë mbetur sidomos i sallës sportive në Vrellë, por sipas analizës time projekti për kanalizime të fshatit Saradran mendoj të hynë ne rend për shkak që kanalizimi siç e dimë ne të gjithë është ma me prioritet se shumica e projekteve të tjera, unë e kam propozuar edhe në Komitetin për

Politikë dhe Financa për me ndërhyrë në kanalizimet në fshatin Saradran në disa lagje si "Dërdallaj" "Tafilaj" e kështu me radhë, e shpresoj që është ndonjë mundësi se nuk mundem të ja bëj me gisht asnjë projekti që këtë projekt hiqe e vend këtij me sjellë këtë, vetëm se është shumë e nevojshme, e kisha lutur ekzekutivin dhe juve që me e bërë të pamundurën që në këtë drejtim të fillohet të punohet me faza sepse ka lagje shumë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit e nderuar! Vetëm se komunikova edhe me drejtorin e drejtorisë për Zhvillim Ekonomik se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është premtuar që me bartje të mjeteve të ndahen 50 mijë euro për kanalizimin në Saradran që e ke kërkuar si fazë e parë. Fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë nuk dua të lëshohem në projekte të veçanta një rrugë ose një kanalizim, e kam parë buxhetin edhe siç e kam thënë edhe më herët në drafte të tjera nuk është buxhet i ri, është buxhet i politikave të mëparshme. Desha të lidhem me kolegun Haki se bëri thirrje me e votuar këtë buxhet se ky është i qytetarëve, jemi për qytetarët, neve na kanë votuar edhe për disa projekte të tjera p.sh, jam skeptik në këtë buxhet sepse po ka vetëm projekte kapitale, rrugë kanalizime etj, edhe opozita edhe pozita në premtimet e fushatës kanë qenë disa gjëra pak më ndryshe si për nënkryetarin si prej kryetarit edhe prej neve, se ka qenë gjendja ashtu dhe është ende që duhet me investuar për rininë, për shkollat për dixhitalizimin, për projekte që na mbajnë këtu dhe na japin shpresë. Si në buxhetet e mëparshme u fol edhe pabarazia, ka pabarazi. Neve na kanë votuar qytetarët për ato çka i thashë, për me ja kthyer shpresën pikërisht për atë arsye e kam marrë votën, edhe kryetari e nënkryetari kanë thënë për me ja u paguar grave në biznes qiranë, kanë pasur gojën plotë për rini e që rini këtu nuk po shoh. E kanë përmendur dyfishimin e buxhetit të sportit, nuk ka dyfishim, e kanë përmendur arsimin, bujqësinë, mi subvencionuar bizneset që merren me peshk, nuk ka asgjë në atë drejtim, kanë folur për gratë me ja u dhënë për fëmijët e porsalindur ka 100 euro edhe 200 janë përmendur, pra po flitet vetëm për rrugë kanalizim asgjë tjetër. Buxheti duhet me qenë që me e parë pak edhe gjendjen momentale që e kemi, siç po e shoh këtu as rrugë as kanalizime nuk do të na nevojiten asgjë hiç, krejt rinia shkuan. Pastaj është investimi në turizëm e ka përmendur shumë kryetari, kishte qenë mirë me i tërhequr investitorët bjeshkët i kemi të bukura. Këto ishin pjesë që desha t'i diskutoj e kam për buxhetin në tërësi jo për një projekt të caktuar, por këto gjëra ishin dashur të jenë në buxhet, jo vetëm rinia por edhe prindërit janë pro me i ndalur rininë këtu, janë kundër rrugës dhe kanalizimit. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- kryetari e ka kërkuar fjalën.

Kryetari i komunës- faleminderit kryesues , faleminderit Agron! Qytetarët që na kanë votuar na kanë votuar duke i dëgjuar vizione, vizioni që po aplikohet është vizioni që unë e kam prezantuar. Dua të flas për proces të implementimit të Draft-Buxhetit, është filluar për një vit as nuk përmirësohet për një vit, as nuk përfundon për një vit e as për një mandat. Dukuri të cilat pa dashur tu jap konotacion partiak prekin çdo komunë apo fshat të Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh kë e kanë kryetar komune. Ne i kemi dy goditje të lëvizjeve, e para është prej diaspore e dyta prej Prishtine. Në bazë në analizave që po i bëj më shumë na godet në kuptim të lëvizjes së njerëzve Prishtina se diaspora. Po e filloj prej rinisë, investim më të madh e më vizionar e me të mençur sesa investimi në shkollim nuk e di se ka, jemi një ndër komunat që ka ndarë bursa më shumë për kokë banori, te çështja e turizmit janë dy rrugë kryesore që po shkojnë nga finalizimi, pjesa e Moknës që është në menaxhim tonin direkt, kemi përgatitur infrastrukturë paraprake ligjore që e parandalon keqtrajtimin e asaj pasurie. Ka shumë që

vazhdojnë ta keqpërdorin pa ndonjë lloj leje, apo respektimi të këtij institucioni. Te çështja e subvencionimit të fëmijëve të porsalindur, është aq e vështirë sa me i siguruar mjetet për bursa, i kemi katër vjet mandat jemi vetëm në vitin e dytë. Te sporti, konform secilës rregullore për subvencionim qoftë për kategorizim të klubeve, qoftë për subvencionim të klubeve që kanë korr sukses në arenën kombëtare qoftë për subvencionim të lojtarëve apo të atyre klubeve që kanë korr sukses në arenën ndërkombëtare, dyfishimi i buxhetit të sportit ka ndodhur vjet, bashkë me partnerin e koalicionit me të cilin e kemi bërë harmonizimin e vizionit, hiç më larg se javën e kaluar e kemi bërë analizë me Aliun konkretisht, të mjeteve që na kanë mbetur të shpërndara në drejtori të subvencioneve në mënyrë që me e shikuar mundësinë buxhetore që sa e kemi me e organizuar një thirrje të re publike për klubet të cilat marrin pjesë në gara ndërkombëtare. Ka klub që përkrahjen tonë e ka quajtur vitra, e po i njëjti pas dy jave ka ardhur me i marrë ato vitra, është për keqardhje. Subvencionimi i qirasë për bizneset e grave vetëm kanë filluar Agron, jo fatkeqësisht direkt prej buxhetit komunal po përmes bashkëpunimit me organizata që bëjnë përkrahjen e grave në biznes. Besoj që në fillim të vitit të ardhshëm do ketë thirrje publike që një përqindje të vogël të atij projekti e financojmë në shenjë simbolike e pjesën më të madhe organizatat që bëjnë përkrahjen e grave në biznes. Analizë po i bëhet edhe pagesës së çerdheve, kategoritë e veçanta të cilat do të trajtohen deri në fund të mandatit që të finalizohet premtimi që çdo fëmijë i qytetit të Istogut me e pasur mundësinë që me i marrë shërbimet për çerdhe publike, përndryshe jemi një ndër komunat që kemi më së shumti fatmirësisht me tendencë në rritje, finalizim e sipër po e quaj përkundër problemeve në ekzekutim edhe për shkak që është kontratë e ministrisë, edhe në fillim e sipër çerdhja e re në fshatin Gurrakoc çerdhe që realisht është shtëpi e planit që nuk i plotëson më kriteret ku ministria e Arsimit i kriterizon çerdhet. Përndryshe faleminderit për diskutimin, edhe për ty e për secilin qytetar, është e pamundur me e realizuar 100% të premtimeve, po konsideroj që shifrën deri 90% deri në fund të mandatit ka me e prekur edhe realizimi i premtimeve të cilat i kemi bërë në fushatë të bazuara në analiza në atë kohë jo vetëm në dëshirore por edhe analiza që na ka dhënë llogaritë buxhetore të cilat i kemi pasur në dispozicion. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! A e dëshiron dikush tjetër fjalën? Hajrush Shoshi e ka kërkuar fjalën.

Hajrush Shoshi- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë vetëm desha, një fjalë e dëgjova që nuk ka palestra sportive, është mirë që ta dinë që katër palestra sportive janë aktive sot në komunën e Istogut. Jemi ndoshta komuna e parë që kemi më së shumti palestra të sporteve në arsim. Kemi diskutuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, te ndërtimi i parkut pushues dhe rekreativ në Banjë, jemi dakorduar edhe në Komitet nëse duhet edhe tani që të votohet që të ndërrohet ky emër dhe të bëhet ndërtimi i gjelbërimit dhe infrastrukturës në Banjë, pra janë 80 mijë euro. E kam edhe një pyetje, janë dy rrethoja të poligonit sportiv dhe vendosja e barit sintetik në shkollën "Zymer Zeka" në Kaliqan, janë 20 mijë euro ndërsa furnizimi me bari sintetik në shkollën "Hysni Zajmi" në Vrellë janë 37 mijë euro, a mos është bërë ndërrimi i këtyre shifrave, sepse në Kaliqan duhet edhe rrethoja edhe bari sintetik, ndërsa në Vrellë vetëm bari sintetik, e këtu ka mjete më shumë. Edhe i kemi te dy kallda, është bërë blerja e gjeneratorëve 35kw për institucionin "Gëzimi Ynë" në Istog dhe në shkollën fillore "Trepça" në Banjë. D.m.th unë propozoj që këto 35 kw tërhiqen dhe të mbetet vetëm blerja e gjeneratorit. Propozimi konkret është vetëm të hiqet 35 kw, mos të figuroj, të jetë vetëm blerja e gjeneratorëve për institucionet e arsimit para fillor edhe është në rregull. U fol shumë rreth projekteve të gjithë kemi mangësi, mirëpo çdo vit do të ndërtohen rrugë kanalizimet dhe besoj që shumë shpejt edhe këto gjëra do të përfundohen dhe do të kalojmë në kërkesa tjera cilat sigurisht që do të jenë me prioritet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit shumë i nderuar! A dëshiron edhe dikush tjetër fjalën? Pasi që jo fjalën e ka Kryetari i komunës.

Kryetari i komunës- nuk po dua ta teproj, përpos që me e falënderuar secilin për diskutimet në lidhje me Draft-Buxhetin në formën se si kuvendarët e shohin projekt buxhetin e vitit të ardhshëm me e bërë dhe me e përsërit thirrjen që e bëra në fillim, përkrahje përkundër mospajtimeve që mundem me i pasur politike e partiake, përkrahje për këtë Draft-Buxhet i cili do të shkoj në interes të qytetarëve të komunës së Istogut. Vitin e kaluar ka qenë hera e parë për komunën e Istogut që nuk është votuar në mënyrë unanime, ka pasur mandate me bashkëqeverisje dhe pa të, mirëpo projekt buxheti partitë i ka bashkuar. Unë e di që ka këtu propozime edhe të juaja, informata të sakta, është hapur si derë për me e përçar mesazhin e bashkëpunimit. E kemi obligim parësor që atë epitelin që e kemi si njerëz të Istogut me vazhduar me mbajtur e me tentuar me edukuar sa më shumë gjenerata me atë frymë. Edhe njëherë bëj thirrje që ky Draft -Buxhet të votohet në mënyrë unanime përkundër mospajtimeve që politikisht mundemi me i pasur. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit kryetar! Mua më duhet ta hedh në votim propozimin e Hajrushit, për ndërrimin e emrit, urdhëro konkret Hajrush edhe njëherë si është emri dhe si po propozon të bëhet?

Hajrush Shoshi- emri është ndërtimi i parkut pushues dhe rekreativ në Banjë, propozoj që të ndërrohet ky emër dhe të bëhet ndërtimi i gjelbërimit dhe infrastrukturës në Banjë. Me e heq kryetar parkun dhe mund të punojmë edhe aty sepse mund të shfrytëzojmë këto mjete më mirë.

Kryesuesi i Kuvendit- e hedhim në votim propozimin e Hajrushit, për ndryshimin e emrit jo ndërrimin, kush është për?

Konstatohet që nga 23 anëtarë të Kuvendit 16 janë për, 0 kundër dhe 7 abstenime miratohet propozimi i anëtarit të Kuvendit z. Hajrush Shoshi për ndryshimin e emrit të projektit "ndërtimi i parkut pushues dhe rekreativ në Banjë" në "ndërtimi i gjelbërimit dhe infrastrukturës në Banjë".

E hedh në votim projekt -buxhetin për vitin 2024-2026, kush është për?

Konstatohet që nga 23 anëtarë të Kuvendit 17 janë për, 6 kundër dhe 0 abstenime miratohet Draft-Buxheti për vitin 2024-2026.

Uroj juve dhe qytetarët e komunës së Istogut që ky projekt buxhet të realizohet në tërësi dhe të jetë në shërbim të tyre. Faleminderit shumë!

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- ju kisha lutur që pasi që ka për të kaluar nëpër hapa deri të vjen prapë në Kuvend në Komitet e në diskutim publik, kush është që ta votojmë, që kjo pikë të shkoj në diskutim publik?

Konstatohet që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime votohet që pika e rendit të ditës "Shpallja në diskutim Publik e Draft-Statutit të Qendrës për Punë Sociale në komunën e Istogut, të shkoj në diskutim publik.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- kush është që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në diskutim publik?

Konstatohet që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mënyrë unanime votohet që pika e rendit të ditës "Shpallja në diskutim Publik i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës në Istog 2024-2026" të shkoj në diskutim publik.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj- unë i kam dy pyetje. Pyetjen e parë e kam bërë edhe njëherë por drejtori nuk ka qenë shumë i qartë se si kemi me ardhur deri te rregullimi apo zëvendësimi i ulëseve në miniparkun në Vrellë, janë dëmtuar shumë. Ndërkaq te pyetja e dytë kam një kërkesë nga banorët e lagjes "Haziraj" nga Vrella të cilët kanë problem me të gjitha gjërat elementare siç thonë ata. Rrymë shumë të dobët, mungesë të ndriçimit, mungesën e kanalizimit dhe rrugët e mbyllura nga mexhat, thonë që janë të lënë pas dore. A do të investohen në ndonjë problem të kësaj lagje? Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Agron Gashi e ka fjalën.

Agron Gashi- e kisha një pyetje për drejtorin e Bujqësisë por nuk qenka këtu drejtori. Është një pyetje banorët e lagjes "Imeraj" në Lluga, e kanë bërë edhe më herët një kërkesë është një jaz aty që kalon, i cili prej kohës së vërshimeve ka dalë nga shtrati dhe janë diku dhjetë hektarë tokë që nuk po mundën me i punuar dhe po ju prishen të mbjellat. Kanë thënë që kanë bërë kërkesë por enden nuk ka diçka, dhe kanë thënë që sa është koha kështu që nuk rritet niveli i ujit mundet të ndërhyjë sepse me vonë nuk mund të ndërhyhet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- drejtori i Zhvillimit Ekonomik, z. Genc Ademaj e ka fjalën.

Genc Ademaj- po ndërlidhem me pyetjen e Agronit sa i përket lagjes "Imeraj" ne i kemi vizituar dhe e kemi dërguar edhe një bager të vogël të Hidrodrinit por nuk kanë mundur të intervenojnë për shkak të asaj që e the edhe ti, ka pasur vërshime komplet pjesa e shtratit të kanalit kullues, nuk kanë mundur të intervenojnë. Ne e kemi një kontratë që jemi në fazën e procedurave tash e dy muaj nëse nuk gabo, momentin që nënshkruhet ajo kontratë hapi parë është hapja e atij kanali që i ruan edhe nga vërshimet, se aty rreziku është nga lumi i Istogut niveli i të cilit është ngritur. Po brenda këtij viti ajo realizohet pa problem.

Kryesuesi i Kuvendit- Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- mbledhjen e kaluar e pata bërë një pyetje, rreth të hollave që janë mbledhur si ndihmë për shkak që kanë qenë vërshimet e dyta, dhe nuk kam marrë përgjigje me shkrim, a e keni gati përgjigjen a duhet të pres ende dhe e kam një pyetje tjetër e cila ka qenë e ngritur edhe më herët në mandatin e kaluar, a do të aktivizohet inkubatori i biznesit a jo? Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Fjalën e ka Genc Ademaj.

Genc Ademaj- profesoreshtë, sa i përket donacioneve të brendshme dhe të jashtme, këto janë të ndara, ne e kemi bërë kërkesën në departamentin e thesarit për bartjen në kategorinë e subvencioneve janë gjithsejtë nga burimet e brendshme dhe të jashtme afërsisht 31 mijë euro, nga të cilat do të përkrahen familjet që e kanë raportin e vlerësimit mbi shumën e dëmeve që ju kanë bërë, nëse nuk gaboju janë diku 52 familje që janë prekur dhe do të shpërndahet buxheti vetëm për këto familje në fund të vitit do të prezantojmë një raport të detajuar cilat familje janë përkrahur dhe vlera e përkrahjes. Te pyetja tjetër, te inkubatori i biznesit, ne e kemi një inkubator që është realizuar me ministrinë e Kulturës në atë kohë para shumë viteve që është në shtëpinë e Kulturës, nuk ka qenë funksional, pastaj e kemi bërë me fondet e Bashkimit Evropian një qendër të inovacionit e cila ka shërbyer edhe si inkubator i biznesit nga ku i kemi përkrahur mbi 60 biznese të reja dhe ekzistuese në të kaluarën, janë përkrahur qoftë për krijimin e vendeve të reja të punës me grante. Prej pandemisë nuk është aktive, për momentin është duke u rinovuar salla me fondin që e kemi për Energji dhe Eficiencë, dhe momentin që finalizohen punimet do të jetë aktive dhe në dispozicion për të rinjtë. Inkubatori dhe qendra e Inovacionit ka kaluar në menaxhim të KRVL-së ja kemi dhënë në shfrytëzim që po mbajnë edhe aktivitetet dhe po ju ndihmojnë të rinjtë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Ajshe Metaj e ka fjalën.

Ajshe Metaj- qëllimi i këtij inkubatori ka qenë çështja e hapjes së vendeve të lira të punës, nuk më bënë përshtypje a është qendër e inovacionit apo inkubator i biznesit. Besoj që do të formohet edhe të realizohen ato premtë që janë bërë. Faleminderit!

Drejtori Genc Ademaj jep sqarime të tjera.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor për ekzaminimin. Fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- e pata një pyetje për drejtorinë e Administratës, kur e keni bërë ngritjen e taksës komunale për regjistrim të automjeteve, është bërë 15 euro dhe 30 euro si duket, mirëpo të gjithë ata që janë duke i regjistruar automjetet me E-kosova del 10 euro taksa, ndërsa në komunë i marrin nga 15 euro, a ka mundësi që edhe ata që e marrin fletëpagesën në komunë ta marrin 10 euro, ose 20 euro për kamion, sepse po bëhet një laramani të cilën qytetarët veç e kanë parë që nuk është në rregull. Edhe e kam pasur një pyetje për drejtorin e Shëndetësisë, se deri ku ka arritur puna që të funksionalizohet mamografi të cilin e kemi blerë vitin e kaluar. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Genc Ademaj e ka fjalën.

Genc Ademaj- ndryshimi i taksës nga portali E-kosova me taksën që zyrtarët komunal e inkasojnë ose lëshojnë fletëpagesën, është e vërtetë që po dallon për një arsye. Që nga aprovimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoka të vitit të kaluar, ne i kemi bërë disa kërkesa bashkë edhe me zyrtarin e IT-së në kuadër të ASHI-t të cilët e kanë për obligim me e bërë ndryshimin në platformë, në mungesë të kontratës për editim të vlerës së taksës ka mbetur tash e gjashtë vite pa hyrë në fuqi edhe në pjesën e E-kosovës. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori i Shëndetësisë, Zenel Shatri.

Zenel Shatri- përshëndet të gjithë të pranishmit! Mamografi ka qenë klasik tani është duke u shndërruar në digjital, procedurat e tenderimit janë përfunduar, muajin e ardhshëm edhe kur fillon fushata për Ndërgjegjësimin e Kancerit të Gjirit do të aktivizohet. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka Valbonë Demaj-

Valbonë Demaj- përshëndet të gjithë të pranishmit! Edhe unë e pata një pyetje për drejtorin në lidhje me mamografin, pasi që muajin e ardhshëm është fushata e Vetëdijesimit edhe ne si grup i grave asamblesite së bashku me zyrtaren për Barazi Gjinore dhe zyrtaren për të Drejtat e Njeriut kemi një varg aktivitete, desha ta bëj një pyetje, edhe pse funksionalizohet mamografi, prapë e kemi problem leximin e cd-së së mamografit, a mundet me ma dhënë dikush një përgjigje nëse ka mundësi për një radiolog që nëse gjatë fushatës që ka gra që vijnë ta bëjnë mamografin të kenë mundësi ku ta lexojnë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Valbonë! Fjalën e ka drejtori i Shëndetësisë.

Zenel Shatri- faleminderit Valbonë për pyetjen! Do ta marrim një konsulent veç është mbyllur konkursi, tash përzgjedhja e tyre do të bëhet, ka të lajmëruar, kështu që ajo çështje do të zgjidhet.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor! Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- e kam një pyetje për drejtorin e Zhvillimit Ekonomik pasi që është menaxher i projektit të ujësjellësit të Mbi Vadës, çfarë po ndodhë me projektin austriak, më herët e keni cekur që për shkak të sasisë së ujit nuk keni pasur mundësi ta bëni shpimin te burimi, tani pas reshjeve prapë do të ngritët niveli, ku jemi me punë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit! Fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- Negjdet për çështjen e ujësjellësit kam pasur shumë qytetarë në zyre, fatmirësisht e mirëkuptojnë edhe dinë ta vlerësojnë vlerën e projektit. Drejtori vazhdon jap sqarimin e detajuar lidhur me projektin e ujësjellësit në Mbi Vadë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor për ekzaminimin e detajur, besoj Negjdet nuk ka mbetur diçka për tu thënë. A ka edhe dikush pyetje nga anëtarët e Kuvendit? Negjdet Ramaj e ka fjalën!

Negjdet Ramaj- po e ceku sepse po bëjnë shumë zhurmë banorët sepse po kanë nevojë shumë për ujë të pijes.

Genc Ademaj- ata banorë nuk është që kanë mbetur pa ujë që një vit apo dy, ne jemi duke e premtuar dhe jemi duke e realizuar, por nuk është komuna fajtores që nuk ka ujë në këtë rast.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor. A ka edhe dikush pyetje nga anëtarët e Kuvendit? Po konsideroj që jo.

Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:15

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj



Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

